



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
**611-23-13347-5-5-8/C719**



## KONTRATË FURNIZIMI

KUSHTET E PËRGJITHSHUME DHE TË VECANTA DHE ANEKSET E NDËRLIDHURA

### TITULI: FURNIZIM ME IT PER INSTUTIONET E KOMUNES SE DRENASIT

Numri identifikues: **611-23-13347-5-5-8** Përgatitur në Drenas, 13.12.2023 Nr. i arkivit: 02-40/01/60001

#### PALET NË MARRËVESIJE

KOMUNA E DRENASIT - DRENAS, përfaqësuar nga GEZIM HAJDINI, Zyrtar i Prokurimit (më tutje "Punëdhënës")

"FutureBITS" SHPK - Prishtinë përfaqësuar nga VIGAN AJAZI, (më tutje "Kontraktues")

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë: nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim: **FURNIZIM ME IT PER INSTUTIONET E KOMUNES SE DRENASIT**

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë: 10 DITE nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: **FURNIZIM ME IT PER INSTUTIONET E KOMUNES SE DRENASIT**

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atçherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërpërjetës i kontratës.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **97,000.00 €**; [NENTEDHJETE E SHTATE MIJE E TRIDHJETE] Euro.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

[Nëse disa artikuj iu nënshtrohen ndryshimeve]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: 4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Vecanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparrësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Vecanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njera tjeterën; dhe në rastë të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparrësisë në të cilin janë dhënë më siptë.

Neni 6 Komunikimet

6.1 E gjitha komunikimet me shkrin qe kane te vejne me kete Kontrate ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njera apo eine furnizuesit nga ana tjeter duhet te cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj te identifikimit dhe duhet te dergohen me postë, faks, email ose te dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikates me shkrin, dërguesi duhet te kërkojë vërtetim të pranimit të komunikates së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

6.4 Kjo kontratë është e përgantitur në gjuhën shqipe në tri origjinalë, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinalë për Furnizuesin.

## KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkuar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Produktet" përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazhme.

1.3 "Autoriteti Kontraktues" do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 "Furnizues" do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 "Inkotermet" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 "Furnizim" do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 "Çmimi i kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohej në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tillë dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 "Shërbimet pas shitjes" do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrimet e ngashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vët ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrin nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përsitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënes së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjeter i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovali i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhëni e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjeter financiar.

### Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontrates qe do te nenkontraktionen une iuencitet i nenkontraktuesve i denen te ultura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Furnizuesi duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njofimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmblushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkizati me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

#### Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

#### Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues përmartjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës se Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkua e licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkua apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

#### Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçëtësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu eksposuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të asërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlgimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

#### Neni 8 Prejardhja

8.1 Furnizuesi do të paraqesë një certifikatë zyrtare të prejardhjes në momentin e pranimit të përkohshëm. Nëse ky obligim nuk plotësohet, kjo do të çojë në ndërprerje të kontratës, me paralajmërim zyrtar.

#### Neni 9 Siguria e ekzekutimit

9.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

9.2 Siguria e ekzekutimit të kontrates do te jetë ne formen e unene ne pjesen IV te kontrates.

9.3 Përveç asaj pjesë të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës se perkohshme të pranimit.

#### Neni 10              **Sigurimi**

10.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet te jene te siguruara plotësisht me një valute lirisht te konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit te rastësishëm te prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj ne mënyrën e specifikuar ne KVK.

10.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 10.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

#### Neni 11              **Programi i realizimit**

11.1 Nëse kërkohet në KVK, Furnizuesi do të dorëzojë një program të realizimit të kontratës që do të aprovohet nga autoriteti kontraktues. Ky program do të përbajë së paku këto:

- i) rendin sipas të cilët Furnizuesi propozon të realizohet kontrata, duke përfshirë dizajnin, prodhimin, dorëzimin në vend të pranimit, instalimin, testimin dhe komisionimin; dhe
- ii) të dhëna dhe informata të tjera të cilat mund t'i kërkojë me arsyë autoriteti kontraktues.

11.2 KVK do të saktësojnë limitin kohor brenda të cilët programi i realizimit duhet t'i dorëzohet për aprovim autoriteti kontraktues dhe afatin e fundit për aprovimin e Autoritetit Kontraktues. Aprovimi i programit nga autoriteti kontraktues nuk e liron Furnizuesi nga obligimet e tij sipas kontratës.

11.3 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin te njoftoj vendimin e tij te aprovimit i përmendur ne Nenin 11.2 brenda afateve te përmendura ne kontratë programi i tillë i realizimit duhet te konsiderohet i aprovuar me kalimin e afateve. Ne qofte se nuk ka afat te caktuar, ato do te konsiderohet te aprovuara 30 dite pas pranimit.

11.4 Asnjë ndryshim material në program nuk mund të bëhet pa aprovimin e autoritetit kontraktues. Megjithatë, nëse progresi i realizimit të kontratës nuk bëhet sipas programit, autoriteti kontraktues mund ta udhëzojë Furnizuesin që ta ripunojë programin dhe ta dorëzojë programin e ripunuar për aprovim te ai.

11.5 Para pranimit të perkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi duhet të furnizoj me manualet e funksionimit dhe mirëmbajtjes së bashku me vizatime, të cilat do të janë në detaje të tilla që do të mundësoj Autoritetit Kontraktues operimin, mirëmbajjen, rregullimin dhe riparimin e të gjitha pjesëve të furnizimeve. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në KVK, manualet dhe vizatimet do të janë në gjuhën e kontratës dhe në formë dhe numrat të tilla të deklaruara në kontratë. Furnizimet nuk do të konsiderohen të përfunduara me qëllim të pranimit të perkohshëm deri sa manualet dhe vizatime e tillë janë furnizuar Autoritetit Kontraktues

#### Neni 12              **Marrëveshjet tatimore dhe doganore**

12.1 Duke iu nënshtruar dispozitave të tjera të përcaktuara në KVK, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për pagesën e të gjitha taksave, detyrimeve të pullës, taksat e licencave, tarifat doganore dhe taksat tjera që lindin apo imponohen deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuarës në vendin e dorëzimit, siç është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

#### Neni 13              **Patentat dhe licencat**

13.1 Përveç në rastet kur është paraparë ndryshe në KVK, Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

#### Neni 14              **Periudha e ekzekutimit të detyrave**

14.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e fiksuar në pajtim me Nenin 2, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 15.

14.2 Përveç kur palët pajtohen ndryshe, realizimi i kontratës duhet të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Furnizuesi ka të drejtë të mos e realizojë kontratën dhe të marrë përfundimin e saj apo kompensimin për dëmin që ka pësuar. Furnizuesit do ta humb këtë te drejtë përveç nëse ai e ushtron atë brenda 30 ditëve nga data e skadimit të periudhës 90 ditësh.

14.3 Nëse mundësohen periudhat e ndara të realizimit për sasi të ndara, këto periudha nuk do të mblidhen në rastet kur një Furnizuesi i jepen më shumë se një sasi.

#### Neni 15              **Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

15.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyë:

- a) Autoriteti kontraktues porosit furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;

- c) Fëngesa apo kushte nzoje që muna te nukojne ne uorezimin e furnizimeve, te c'hai nuk kane mundur te parashinjen ne menyre te mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhë administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përvç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhere;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

15.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë voncesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

15.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

#### Neni 16 Vonesat e ekzekutimit

16.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuar deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

16.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërsi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 16.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të kontratës

16.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së kontratës ai mundet, pasi ta njofojë me shkrim Furnizuesin:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashu do të jetë i detyruar të pagujë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

#### Neni 17 Suspendimi

17.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar për dorëzim në programin e realizimit ose, nëse nuk është specifikuar koha, në kohën kur ato duhet të dorëzohen; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.

17.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkëqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

17.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsy e kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjesë të saj përdërisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

17.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përvç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit për të pezulluar progresiv e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

17.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkizazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

17.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njofuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

17.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbajtjesore, parregullsive ose mashtimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcione rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtimit.

17.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtjesore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtimet kanë

nauonur ne te venete. Nëse ato nuk mund te konfirmohen, reanizimi i kontrates do te rrimoje sa me snipej qe eshte e mundur. Gjatjet përmbytjesore ose parregullsitë do të janë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave irregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 18 Cilësia e furnizimeve

18.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

18.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi i për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuara në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

18.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

## Neni 19 Inspektimi dhe testimi

19. Furnizues do t'i sigurojë që furnizimet t'i dorëzohen në vendin e pranimit me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues t'i vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësítë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që t'i paraqesë ndonjë arsyë për vonesë.

19.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimit apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

19.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektiveve të tillë, Furnizues do të:

- a) I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
  - b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
  - c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

19.4 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përvèç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuara si duhet të rezultateve të testit te Autoriteti kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

19.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpermendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

19.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'i japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimt do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do të janë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohet se është gabim pas ri-testimit.

19.7 Gjatë realizimit të detyrate të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimeve dhe testimit.

Nenj 20 Parimet të përgjithshme të pagesave

20.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës qe duhet t'i behet Furnizues sipas kësaj Kontrate do te specifikohen ne KVK.

20.2 Pagesat qe duhet te bëhen sipas saturës se lëshuar nga Furnizues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

20.3 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshmë për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

20.4 Periudha prej 30-ditësh mund të përzullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose se pse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

20.5 Tërasi që te keqe kaluar arati i funort i unene ne Nenin 20.3, furnizuesi mundet qe, orenua ay muajsn pas pageses se vonuar, te kerkonte interesin per pageset te vonuar me norme te re-zbritje qe zbatohet nga institucion i leshues i Kosoves ne diten e par te muajit ne te cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtate pikte te perqindjes. Interesi per pageset te vonuar do te zbatohet per kohen qe kalon ndermjet dates se afatit te fundit te pageses (nuk perfsihet) dhe dates ne te cilen debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (perfsihet).

20.6 Te gjitha mos pagesat pas 90 ditesh nga skadimi i periudhes se dhene ne Nenin 20.3 do ti jepet te drejtë Furnizuesit qe ose te mos e realizoj kontraten, ose ta nderpres te atje, me paralajmrim prej 30 ditesh per Autoritetin kontraktues.

## Neni 21 Dorëzimi

21.1 Furnizuesi duhet ti dorëzojë furnizimet ne pajtim me kushtet e kontrates. Furnizimet do te jene ne perqiegjesi te Furnizuesit deri ne pranimin e tyre te perkohshem.

21.2 Furnizuesi do ti paketoje furnizimet ashtu siç kercoh per te parandaluar demtimin apo keqesimin e gjendjes se tyre gjate transportit deri ne destinacionin e tyre, siç eshte dhene ne kontrate. Paketimi duhet te jeti i mjaftueshem per te perballuar pa kufizime, bartjen e ashper, ekspozimin ne temperatura ekstreme, kripen dhe renet gjate tranzitit dhe mbajtjen ne ambient te hapur. Madhesia e paketimit dhe pesha duhet ti pereshtaten, nese eshte e mundur, largesis se destinacionit perfundimtar te furnizimeve, dhe mundesis se mungeses se pajisjeve per bartje te rende ne te gjitha pikat gjate transitit.

21.3 Paketimi, shenimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet te jene ne pajtim me kerkesat e dhena ne menyre te hapur ne KVK, dhe i nensstrohen ndryshimeve qe mund te urdhrohen me vonje nga autoriteti kontraktues.

21.4 Asnjë furnizim nuk do te transportohet as te dorëzohet ne vendin e pranimit derisa furnizuesi te keti pranuar urdhri e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do te jeti perqiegjess per dorëzim ne vendin e pranimit te te gjitha furnizimeve dhe pajisjeve te furnizuesit, qe janë te nevojshme per qellime te kontrates.

21.5 Dorëzimi duhet te konsiderohet se eshte berë atëherë kur ka dëshmi me shkrim qe eshte ne dispozicion per te dy palët se dorëzimi i furnizimeve eshte berë ne pajtim me kushtet e kontrates.

## Neni 22 Operacionet e verifikimit

22.1 Furnizimet nuk do te pranohen derisa te jene realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime te Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund te realizohen para transportit, ne piken e dorëzimit dhe/ose ne destinimin final te malrave.

22.2 Autoriteti kontraktues, gjate progresit te dorëzimit te furnizimeve dhe para se te merren furnizimet, duhet te keti fuqine qe te urdhrojë ose te vendosë:

- heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohe ose kohesh siç eshte specifikuar ne urdhër, te te gjitha furnizimeve te cilat, sipas mendimit te autoritetit kontraktues, nuk janë ne pajtim me kontraten;
- zëvendësimin e tyre me furnizime te mira dhe te pereshtatshme;
- heqjen dhe ri-instalimin e mirë te pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme te tyre ose pagesat e pjesshme te tyre, ose ndonjë instalim qe lidhet me materialet, mjeshterin e ose dizajnin per te cilin eshte perqiegjess furnizuesi, e qe sipas mendimit te autoritetit kontraktues nuk eshte ne pajtim me kontraten;
- qe puna e berë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë ne pajtim me kontraten, ose qe furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontrates.

22.3 Furnizuesi, sa me shpejt qe eshte e mundur dhe me shpenzime te veta, duhet ti evitoje defektet e specifikuara. Nese Furnizuesi nuk vepron sipas ketyre urdhreve, Autoriteti kontraktues do te keti te drejtë te punesoje persona tjerë per t'i zbatuar urdhrat dhe te gjitha shpenzimet qe janë pasojë e kësaj, apo qe do te shfaqen per shkak te kësaj, Autoriteti kontraktues do ti zblesë nga parate qe do te paguhen ose te cilat do te bëhen obligim per t'u paguar Furnizuesit.

22.4 Furnizimet qe nuk janë te cilesisë se kérkuar do te refuzohen. Nje shenje speciale mund tu vendoset furnizimeve te refuzuara. Shenja nuk duhet te jetet e atille qe ti ndryshoje ato, apo te ndikojë ne vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do ti heqë nga vendi i pranimit, nese kete e kérkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe qe e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nese kjo nuk realizohet ato do te hiqen me te drejtë me shpenzim dhe me rrezik te furnizuesit. Te gjitha punet qe perfshtijnë materialet e refuzuara do te refuzohen.

## Neni 23 Pranimi i perkohshem

23.1 Furnizimet do te merren persipëri nga Autoriteti kontraktues kur te jene dorëzuar ne pajtim me kontraten, ti kenë kaluar ne menyre te kënaqshme testet e kérkuara, dhe te jene autorizuar, si dhe te jetet leshuar një certifikatë e pranimit te perkohshem ose nese konsiderohet se eshte leshuar.

23.2 Furnizuesi mund te bejë kérkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, per një certifikatë te pranimit te perkohshem atëherë kur furnizimet te jene te gatshme per pranim te perkohshem. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditesh nga pranimi i aplikacionit te furnizuesit do te veproje sipas njërs nga këto më poshtë:

- ti leshojë furnizuesit certifikatën e pranimit te perkohshem me një kopje per Autoritetin kontraktues duke thënë, nese kjo eshtë e perfshtatshme, rezervat e tij, dhe përvceq tjerash, edhe datën ne te cilën sipas mendimit te tij janë perfunduar furnizimet ne pajtim me kontraten dhe janë te gatshme per pranim te perkohshem; ose
- te refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin te cilin, sipas mendimit te tij e kérkon Furnizuesi per ta leshuar certifikatën.

23.3 Nese rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë te pamundur qe te vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjate periudhes se fiksuar per pranim te perkohshem ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë per ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nese eshte e mundur, ne konsultim me

furnizuesin. Çertifikata e pranimit ose e refuzimit do te pergaute brenda 30 dites ne te cilen kjo pamundesi pushon se ekzistuar. Furnizuesi nuk do te nxise shfaqjen e ketyre mrethanave per te evituar obligimin e paraqites se furnizimeve ne një gjendje te përshtatshme per pranim.

23.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose te lëshoje certifikatën e pranimit te përkohshëm ose te refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do te konsiderohet se ka lëshuar certifikatën ne ditën e fundit te asaj periudhc, përveç ne rastet kur certifikata e pranimit te përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë te pranimit përfundimtar. Nëse furnizimet ndahan me kontratë ne pjesë, Furnizuesi do te ketë te drejtë te bëjë kërkesë per certifikatë te veçantë per secilën pjesë.

23.5 Ne raste te dorëzimit te pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon te drejtën per te dhënë pranim te pjesshëm e te përkohshëm.

23.6 Pas pranimit te përkohshëm te furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më per përdorim përkizazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do te heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe te bëjë ndonjë ndryshim te gjendjes se vendit te pranimit siç kërkohen ne kontratë.

#### Neni 24 Obligimet per garanci

24.1 Furnizuesi do te garantoje që furnizimet te jenë te reja, te papërdorura, te modeleve te fundit dhe te përfshijë te gjitha përmirësimet e kohëve te fundit ne dizajn dhe materiale, përveç nese kërkohet ndryshe ne kontratë. Furnizuesi do te garantoje që asnjë nga furnizimet te mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshteria. Kjo garanci do te mbetet e vlefshme ne atë mënyrë që saktësitet ne KV.

24.2 Furnizuesi do te jetë përgjegjës per mënjanimin e defekteve, ose dëmeve ne ndonjë pjesë te furnizimeve te cilat mund te paraqiten, apo te ndodhin gjatë periudhës se garancisë dhe te cilat:

- rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë se gabueshme ose dizajnit jo te mirë nga Furnizuesi; ose
- rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës se garancisë; ose
- shfaqen gjatë ndonjë inspektimi te bëre nga Autoriteti kontraktues ose ne emr të tij.

24.3 Furnizuesi me shpenzime te veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo te mund te praktikohet. Periudha e garancisë per te gjithë artikujt e ndërruar ose te riparuar do te fillojë përsëri nga data ne te cilën është bëre ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit te autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do te vazhdohet vetëm per atë pjesë te furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

24.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës se garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë k Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor te paraparë ne njoftim, autoriteti kontraktues mund te:

- te korrigojë defektin apo dëmin vetë, ose te punësojë dikë tjeter per ta bëre punën ne rezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, ne te cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do te zbritet nga paratë që duhet te paguhen ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga te dy;
- ne rast se nuk ka sasi te duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që te merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- te ndërpresë kontratën.

24.5 Obligimet e mirëmbajtjes do te parashihen ne KV dhe ne specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës se garancisë nuk është e specifikuar, ajo do te jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do te fillojë ne datën e pranimit te përkohshëm.

#### Neni 25 Shërbimet pas-shitjes

25.1 Shërbimet pas-shitjes, nese kërkohen ne kontratë, do te jepen ne pajtim me te dhënat e parapara ne KV. Furnizuesi do te marrë përsipëri te realizojë ose te organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe te riparimit te furnizimeve dhe te sigurojë shpejt pjesët rezervë. KV mund te saktësojnë që Furnizuesi te sigurojë ndonjë ose te gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë te bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- pjesët rezervë te cilat Autoriteti kontraktues mund te vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- ne rast te ndërpërjetës se prodhimit te pjesëve rezervë, duhet te lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues per t'i mundësuar që te blejë pjesët e kërkua dhe, pas ndërpërjetës, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nese kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

#### Neni 26 Pranimi përfundimtar

26.1 Pas skadimit te periudhës se garancisë ose, ne rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit te periudhës se fundit, dhe atëherë kur te jenë zgjidhur te gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshoje Furnizuesit një certifikatë te pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën ne te cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe ne mënyrë te tillë që autoriteti kontraktues te jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do te lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës se garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 24 te jenë përfunduar ne mënyrë te tillë që te jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

26.2 Kontrata nuk do te konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa te jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa te konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

26.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do te mbeten te detyruar per plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit te certifikatës përfundimtare te pranimit dhe te cilat kanë mbetur te parealizuara ne kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve te tilla do te përcaktohen duke iu referuar dispozitave te kontratës. 8

## Neni 27 Ndërprerja e kontratës

- 27.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.
- 27.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:
- dëmet; dhe/ose
  - ndërprerjen e kontratës.

27.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- dëme të përgjithshme; ose
- dëme të likuidueshme.

27.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

## Neni 28 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

28.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- kur Furnizuesi në mënyrë përbajtjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- Furnizuesi dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dëshitim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- Furnizuesi falimenton ose është duke u myllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronhet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngashme e paraparë në legjislacionin apo në tregulloret nationale;
- Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rendë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjeter ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- Furnizuesi, pas një procedure tjeter të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- shfaqet ndonjë paaftësi tjeter ligjore që i pengon realizimin të kontratës;
- Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

28.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruej ndonjë kontratë tjeter me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përbushjen duhet të pushojë së ekzistuar menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të janë paraqitur tashmë.

28.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njofshimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm përsëri ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të përgjithshme.

28.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuar dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

28.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të janë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

28.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

## Neni 29 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

29.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet t'i paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.

- vaznominisit nuk artin t'i piolesoje obligimet e veta eune pas rikujimeve te persentura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

29.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjeter sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhc Furnizuesit.

29.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 29.1 , Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

#### Neni 30 Forca madhore

30.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

30.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, blokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëima, vërsimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjeter e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

30.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 16 dhe 28, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjeter dëshrimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 20.5 dhc 29, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjeter i dëshrimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

30.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrëthanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjeter, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrëthanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të yazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdërisha është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues

30.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhreve të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 30.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

#### Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetren me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkесës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkесës. Periuðha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetren.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes

#### Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kérkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

#### PJESA II LE KONTRATES KUSHITET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhc/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

|                                     |           |   |
|-------------------------------------|-----------|---|
| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës |           | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkates në KPK             |
| Përshkrimi i nenit                  | Nr. Nenit | <b>FURNIZIM ME IT PER INSTUTICIONET E KOMUNES SE DRENASIT</b> |



|  |      |   |
|--|------|---|
| Liqji i zbatueshëm<br>dhe gjuha                          | 2.1  | Liqjet e Kosovës qe janë ne fuqi do te zbatohen per te gjitha çeshtjet qe nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do te jetë gjykata perkatëse në Prishtinë.   |
|  | 2.2  | Gjuha e përdorur do të jetë ( <i>SHQIPE</i> )   |
| Siguria e<br>ekzekutimit                                 | 9.1  | 10 % e vlerës së kontratës, validiteti 40 dite  |
| Sigurimi   | 10.1 | Nuk kerkohet.   |
| Programi i<br>ekzekutimit                                | 11.1 | 10 ditë pas nënshkrimit të kontratës  |
| Tatimet dhe<br>marrëveshjet<br>doganore                  | 12.1 | Të gjitha duhet të paguhën nga Kontraktuesi   |
| Patentat dhe<br>licencat                                 | 13.1 | Sipas specifikonit të përshkruar në Neni 13 i KPKJ  |
| Cilësia e<br>furnizimeve                                 | 18.1 | Furnizimet duhet të janë konform specifikime të kërkuara duke përfshirë Furnizimet duhet të kryhen brenda afatit të paraqitur ne ofertë.  |
| Inspektimi dhe<br>testimi                                | 19.1 | Inspektimin e kryen nga Komuna e Drenasit sa herë që ka nevojë me shpenzime të kontraktuesit.   |
| Pagesa   | 20.1 | Autoriteti kontraktues do t'i paguajë Kontraktuesit shumën e obligimit brenda [30] ditësh pas datës në të cilën është regjistruar pagesa e pranueshme, Menaxhimin e kësaj kontrate e Kryen Menaxheri i Projektit i caktuar me një Vendim nga Kryetari i Komunës , i cili e harton një Plan të Menaxhimit të kontratës konform Nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 Afati i furnizimeve duhet të kryhet sipas afatit të prezantuar nga Ofertuesi. Në komisione të pranimit nuk duhet të caktohen personat që kanë marrë pjesë në hartimin e specifikimeve dhe ata të cilët kanë marrë pjesë në vlerësimin e ofertave. |
| Dorëzimi   | 21.2 | <b>FURNIZIM ME IT PER INSTUTIONET E KOMUNES SE DRENASIT.</b><br>INSTITUCIONET E KOMUNES SE DRENASIT përkatesisht tek Menaxheri i Projektit dhe Komisioni pranues.   |
| Obligimet e<br>garacionit pas<br>pranimit të<br>paisjeve | 24.1 | Garacioni i PER PERMISIM e defekteve DO TE JETE PREJ 1 VITI   |
| 88   | 24.2 | Menaxheri i projektit duhet të jetë pjesë e Planit të Menaxhimit të kontratës dhe obligohet që monitorimin e kontratës në aspektin Ligjor ta kryej sa herë që kerkohet ta kryej konform neneve të kontratës dhe ligjeve në fuqi dhe duhet të bindet se kontrata implementohet ashtu edhe si është hartuar. Poshtu merrë përsipër të përballet (së bashkë me Avokatin komunal) me pengesat eventuale dhe mbrojtjen e kontratës dhe interesave të Komunës para institucioneve tjera.  |

|                                     |      |  |
|-------------------------------------|------|--|
| Shërbimet pas shitjes               | 25.1 | N/A  |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes | 31.2 | Mundesisht në mes të dy palëve..   |
| 9                                   | 32.1 | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit se kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Ekonomike e Qarkut - Prishnica] në pajtim me ligjin në Kosovë.  |
| Pagesat                             | 33.1 | Të gjitha pagesat bëhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtarja për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës për punët e kryera do të caktohet nga Menaxheri i Projektit.   |
| Dorëzimi i dokumentave              | 33.2 | Të gjitha pagesat mund të kryhen nga Zyrtarja për pagesë vetëm nëse janë ofruar dokumentet si: Plani i Menaxhimit, aktvendimet, procesverbalet, raportet, situacionet për punët e kryera, faturat, atestimi, shkresat, fletët e ditarit të punës, sigurimet etj.   |
| Arkimi i dokumentave                | 33.3 | Zyrtarja për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat tretë pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblerjes, t'i arkivoj dhe ruaj.Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palet shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.Një kopje e faturës, raportit të pranimit dhe kontratës pas përfundimit të projektit duhet të dorëzohen tek Zyrtarja për rexhistrimin e pasurisë. |
| Hyrja në fuqi                       | 33.4 | Kontrata hynë në fuqi menjehere pas nënshkrimit të palëve. Kontrata hartohet në 2 kopje origjinale.  |

a. Oferta financiare e Tenderuesit ,

Për Autoritetin Kontraktues

Për Ofruesin e Furnizimeve

|             |   |             |   |
|-------------|---|-------------|---|
| Emri:       | GEZIM HAJDINI   | Emri:       | VIGAN AJAZI   |
| Pozita:     | ZPP   | Pozita:     | DREJTOR   |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |   |
| Data:       | 13.12.2023  | Data:       | 13.12.2023  |
| Vula:       |  | Vula:       |  |



## Lloji i Garancisë: Garanci Kontrate

Për

KOMUNA GLLOGOC

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PASUR PARASYSH QË

FutureBITS SH.P.K.

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marrë përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

FURNIZIM ME IT PER INSTITUCIONET E KOMUNES SE DRENAT

të dhënë me numrin e Prokurimit

611-23-13347-5-5-8

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci;

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emr të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

9,703.00 €

Nëntë Mije e Shtatë Qind e Tre Euro

(shuma e garancisë në numra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkësën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

• Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik përfunduar kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose

• Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dha qjo shkakton dëm të konsiderueshëm te Autoriteti kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme përfundimini e kësaj kontrate; dhe/ose

• Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dha qjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose

• Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që qjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumat brenda limiteve të

9,703.00 €

(shuma e garancisë)

sic është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen arsyet ose bazat përfundimilës së këtij garanci;

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

13.12.2023

deri më

23.01.2024

Prishtinë

datë

13.12.2023

Lëshuar në

Nënshkrimi dhe vuja e Garantuesit

PRISHTINË



# PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Furnizim me paisje te Teknologjise Informatike per nevoja te institucionit dhe shkollave te Komunes se Drenasit

| Nr. | Fajtja                         | Përshtetje         | Spesifikat teknikë teknikë e përdorimit  | Njësi | Sasia | Çmimi me rysht | Vlera     |
|-----|--------------------------------|--------------------|--|-------|-------|----------------|-----------|
| 1   | Furnizim me laptop - Model II  | Prodhuesi:         | BRAND NAME   | Copë  | 199   | 411.56         | 81,900.44 |
|     |                                | Sistemi Operativ:  | windowas 11 Pro 64 bit supported   |       |       |                |           |
|     |                                | Procesori:         | Min. Intel Core i5, Min. gjenerata e parafundit ne daten e publikimit te njoftimit |       |       |                |           |
|     |                                | Memorie:           | Min. 16 GB DDR4  |       |       |                |           |
|     |                                | Disku              | Min. 512GB SSD M.2   |       |       |                |           |
|     |                                | Kartela grafike:   | Integrated, UHD Graphics   |       |       |                |           |
|     |                                | Monitor:           | Display size 15.6", Full HD (1920x1080)  |       |       |                |           |
|     |                                | Bateri:            | Battery Life 8+ hour   |       |       |                |           |
|     |                                | Porte shtesë:      | Min. 1 x USB 3.0-3.2, 1xUSB 2.0, 1 z USB Type C, HDMI or Display Port              |       |       |                |           |
|     |                                | AV:                | Min 720p HD camera, HD Audio speakers, integrated microphone                       |       |       |                |           |
|     |                                | Tjera:             | AC Included + BAG (e njejt me brendin e laptopit)                                  |       |       |                |           |
| 2   | Furnizim me laptop - Model III | Keyboard&Touchpad: | Keyboard with QWERTY   | Copë  | 8     | 666.25         | 5,330.00  |
|     |                                | Garancioni:        | 3 vite   |       |       |                |           |
|     |                                | Prodhuesi:         | BRAND NAME   |       |       |                |           |
|     |                                | Sistemi Operativ:  | windowas 11 Pro64 bit supported  |       |       |                |           |
|     |                                | Procesori:         | Min. Intel Core i7, Min. gjenerata e parafundit ne daten e publikimit te njoftimit |       |       |                |           |
|     |                                | Memorie:           | Min. 16 GB DDR4  |       |       |                |           |
|     |                                | Disku              | Min. 512GB SSD M.2   |       |       |                |           |
|     |                                | Kartela grafike:   | Integrated, UHD Graphics   |       |       |                |           |
|     |                                | Monitor:           | Display size 15.6", Full HD (1920x1080)  |       |       |                |           |
|     |                                | Bateri:            | Battery Life 8+ hour   |       |       |                |           |
|     |                                | Porte shtesë:      | Min. 1 x USB 3.0-3.2, 1xUSB 2.0, 1 z USB Type C, HDMI or Display Port              |       |       |                |           |
| 3   | Furnizim me PC - Model II      | AV:                | Min 720p HD camera, HD Audio speakers, integrated microphone                       | Copë  | 16    | 500            | 8,000.00  |
|     |                                | Tjera:             | AC Included + BAG (e njejt me brendin e laptopit)                                  |       |       |                |           |
|     |                                | Keyboard&Touchpad: | Keyboard with QWERTY   |       |       |                |           |
|     |                                | Garancioni:        | 3 vite   |       |       |                |           |
|     |                                | Prodhuesi:         | BRAND NAME   |       |       |                |           |
|     |                                | Sistemi Operativ:  | windowas 11 Pro64 bit supported  |       |       |                |           |
|     |                                | Procesori:         | Min. Intel Core i5, Min. gjenerata e parafundit ne daten e publikimit te njoftimit |       |       |                |           |
|     |                                | Memorie:           | Min. 16 GB DDR4  |       |       |                |           |
|     |                                | Disku              | Min. 1TB SSD NVMe M.2  |       |       |                |           |
|     |                                | Kartela grafike:   | min dy porte: HDMI+DQ".  |       |       |                |           |
| 4   | Furnizim me Monitor - Model II | Porte:             | Min. 4 x USB 3.0, 2xUSB 2.0, pra total min 6 porte USB, apo më të avancuarë        | Copë  | 16    | 112.5          | 1,800.00  |
|     |                                | Rrjeti:            | Min 1 x Rj45 Gigabit port  |       |       |                |           |
|     |                                | Mausi dhe tastjera | USB Mouse & QWERTY Keyboard  |       |       |                |           |
|     |                                | Tjera:             | EU-US ENERGY STAR  |       |       |                |           |
|     |                                | Audio:             | Integrated sound card  |       |       |                |           |
|     |                                | Power:             | EU Standard  |       |       |                |           |
|     |                                | Garancioni:        | 3 vite   |       |       |                |           |
|     |                                | Prodhuesi:         | BRAND NAME   |       |       |                |           |
|     |                                | Panel size:        | Min.23.5"  |       |       |                |           |
|     |                                | Aspect Ratio:      | 16:9, Widescreen   |       |       |                |           |
|     |                                | Resolution:        | min 1920x1080, IPS, or better  |       |       |                |           |
|     |                                | Contrast Ratio:    | 1000:1, or better  |       |       |                |           |
|     |                                | Viwing Features:   | min. Tilt, Lift,   |       |       |                |           |
|     |                                | Voltage Required:  | EU Standard  |       |       |                |           |
|     |                                | Audio:             | Nuk aplikohet  |       |       |                |           |
|     |                                | Connevity:         | Minimum dy porte: HDMI+DP, varisht nga PC  |       |       |                |           |
|     |                                | Included:          | AC, min. Dy kabillo te „ Connevity“ varësish monitorit                             |       |       |                |           |
|     |                                | Other Features:    | Integrated Speaker EU-US ENERGY STAR Compliant                                     |       |       |                |           |
|     |                                | Garancioni:        | 3 vite   |       |       |                |           |

**AFATI I LIFRIMIT(FURNIZIMIT) T DITË KALENDARIKE**